



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.538/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Violeta Husaj Rugova, kryesues, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik, Lëvizja VETËVENDOSJE! me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër kundër subjektit politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë:

#### VE N D I M

Refuzohen të pa bazuara ankesat A.nr.538/2025, Anr.540/2025, Anr.541/2025, Anr.544/2025, Anr.556/2025 Anr.563/2025, të datës 10.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja VETËVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: A.nr.538/2025, Anr.540/2025, Anr.541/2025, Anr.544/2025, Anr. 556/2025, Anr.563/2025, të datës 10.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja VETËVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët.

Në ankesën A.nr 538/2025, pretendohet se në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht më 9 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë identifikuar se kandidati nga radhët e Koalicionit AAK-Nisma z. Pal Lekaj ka thyer heshtjen zgjedhore me postimet e tij të sponsorizuara në faqen e tij zyrtare. Postimet e tilla të sponsorizuara kanë qenë aktive të sponsorizuara më 9 shkurt 2025, pas orës 07.00 e tutje, ndonëse heshtja zgjedhore kishte filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim, përkatësisht në ora 07.00.Parashtruesi I ankesës si provë ka bashkangjitur CD me materiale dhe foto që dëshmojnë publikimin në kundërshtim me LZP dhe Rregulloren Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Në ankesën Anr.540/2025 pretendohet se në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht më 9 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë identifikuar se kandidatja nga radhët e Koalicionit AAK-Nisma znj. Diellza Kukaj, ka thyer heshtjen zgjedhore me postimet e tij të sponsorizuara në faqen e tij zyrtare. Postimet e tilla të sponsorizuara kanë qenë aktive të sponsorizuara më 9 shkurt 2025, pas orës 07.00 e tutje, ndonëse heshtja zgjedhore kishte filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim, përkatësisht në ora 07.00.Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD me materiale dhe foto që dëshmojnë publikimin në kundërshtim me LQP dhe Rregulloren Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Në ankesën Anr.541/2025 pretendohet se më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Suharekë, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka vërejtur poster të kandidatëve nga radhët e koalicionit AAK-Nisma, në rrjetin social facebook nga Kryetari i Rinisë i kësaj partie në fshatin Gjinovc, Komuna Suharek, z. Arlind Hajdaraj, të vendosur gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht ditën e zgjedhjeve pas hapjes së Vendvotimeve në ora 07:00 ditën e diel. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur Fotografi të gjendjes faktike.

Në ankesën Anr.544/2025 pretendohet se në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht më 9 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë identifikuar se kandidati nga radhët e Koalicionit AAK-Nisma z. Ramush Ahmetaj, ka thyer heshtjen zgjedhore me postimet e tij të sponsorizuara në faqen e tij zyrtare. Postimet e tilla të sponsorizuara kanë qenë aktive të sponsorizuara më 9 shkurt 2025, pas orës 07.00 e tutje, ndonëse heshtja zgjedhore kishte filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim, përkatësisht në ora 07.00.Parashtruesi I ankesës si provë ka bashkangjitur CD me materiale dhe foto që dëshmojnë publikimin në kundërshtim me LQP dhe Rregulloren Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Në ankesën Anr.556/2025 pretendohet se Ditën e zgjedhjeve dhe gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura, më 9 shkurt 2025, rreth orës 13 :50, kandidatja për deputete e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, znj. Saranda Sallteku, ka rishpërndarë në storie përmes rrjetit shoqëror Instagram posterin e vet zgjedhor, ku shfaqen emrat dhe numrat e subjektit dhe kandidatës në fjalë. Kështu znj. Sallteku ka bërë fushatë gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura, çka ndalohet me nenin 37.1.2 të LQP-së. Z. Hamza gjithashtu ka shfrytëzuar rrjetet sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi, në kundërshtim me nenin 8.1.5 të Rregullores (KQZ) nr. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Pamjen e ekranit me storien e kandidatës.

Në ankesën Anr.563/2025 pretendohet se në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht më 9 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë identifikuar se kandidati nga radhët e koalicionit AAK- NISMA, z. Egzon Kelmendi, ka thyer heshtjen zgjedhore me postimin e tij të sponsorizuar në Llogarinë e tij në rrjetin social Facebook. Postimi i tillë ka qenë aktiv i sponsorizuar më 9 shkurt, ora 07.56 minuta, ndonëse heshtja zgjedhore kishte filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim, përkatësisht në ora 07.00.Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur Fotografi që dëshmojnë publikimin në kundërshtim me LQP dhe Rregulloren Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

-PZAP iu drejtua me kërkesë për përgjigje koalicionit AAK-NISMA lidhur me ankesat e parashtruara ndaj të njëjtit subjekt.

Në përgjigjen për ankesën Anr.538/2025 theksohet se në asnjë moment z.Pal Lekaj përmes këtyre postimeve nuk ka bërë fushatë dhe për më tepër të njëjtat janë postuar para datës 09.02.2025 e po ashtu ka pasur një lëshim teknik nga ana e z.Lekaj dhe i njëjti me të renë në dijeni e ka hequr sponsorizimin nga postimet e tilla pra ka qenë një lëshim eventual.

Në përgjigjen për ankesën Anr.540/2025 theksohet postimi i njëjtë është bërë para fillimit të heshtjes zgjedhore ka qenë vetëm një lëshim dhe nuk mund të merret se e njëjta ka bërë fushatë gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore dhe nuk mund të vërtetohet një shkelje e tillë përmes një fotografie që nuk mund të saktësohet që ka qenë aktive sponsorizimi.

Në përgjigjen për ankesën Anr.541/2025 theksohet se fillimisht duhet theksuar se me asnjë provë nuk vërtetohet që z. Arlind Gjinovci është kryetar i rinisë së subjektit AAK në Gjinovc. Prandaj nuk mund të vërtetohet që është konsumuar shkelja e dispozitave të Nenit 37, par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ("LZP"). Me rëndësi të theksohet është se në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet që kjo "story" e publikuar nga ana e z. Gjinovci është publikuar në ditën e zgjedhjeve më 9 shkurt. Për më tepër e vetmja kohë që saktësohet është "6 H - para 6 orëve", andaj në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet që është publikuar me datë 09.02.2025.

Në përgjigjen për ankesën Anr.544/2025 theksohet se në asnjë moment kandidati i njëjtë përmes këtyre postimeve nuk ka bërë fushatë pasi që në asnjërin nga ato nuk bënë thirrje për të votuar subjektin e caktuar politik. Për më tepër këto postime janë bërë shumë më herët sesa data 09.02.2025.

Në përgjigjen për ankesën Anr.556/2025 theksohet se Një ankesë të tillë e kundërshtojmë në tërësi pasi që në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet që kjo "story" e publikuar nga ana e znj. Saranda Sallteku është publikuar në ditën e zgjedhjeve më 9 shkurt. Për më tepër e vetmja kohë që saktësohet është 13:47, por data në asnjë pjesë të fotografisë së bashkangjitur nuk është saktësuar, andaj në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet që është publikuar me datë 09.02.2025.

Në përgjigjen për ankesën Anr.563/2025 theksohet se një ankesë e tillë nuk është e bazuar në asnjë provë konkrete pasi që në asnjë rast nuk përcaktohet me saktësi data se kur postimi i tillë nga ana e z. Kelmendi ka qenë "sponsored" pasi që në fotografinë e bashkangjitur si provë nuk saktësohet asnjë datë apo asnjë orë për të vërtetuar që me të vërtetë postimi ka qenë i sponsorizuar edhe me datë 09.02.2025, e vetmja që shënon është 6 orë përpara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr.05/1-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.538/2025, Anr.540/2025, Anr.541/2025, Anr.544/2025, Anr.556/2025, Anr.563/2025, të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.538/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekte politike LVV kundër koalicionit AAK-NISMA për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pas shqyrtimit të ankesave, gjen se:

-Ankesat janë të pa bazuara.

Paneli pas vlerësimit të ankesave dhe provave të bashkangjitura në ankesat e cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesa dhe provat e bashkangjitura dhe pas hetimeve të bëra, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se mbështetësit dhe kandidatët e AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, kanë thyer rregullat zgjedhore ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë të pa bazuara.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.538/2025, Anr.540/2025 dhe Anr.563/2025, provat e bashkangjitura dhe hetimet e bëra dhe vërtetoi se, postimet në këto raste janë bërë para datës së zgjedhjeve ndërsa nuk mund të vërtetohet se janë postuar apo ri postuar, në ditën e zgjedhjeve, siç pretendohet në ankesa.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.541/2025, Anr.544/2025, Anr.556/2025, provat e bashkangjitura dhe hetimeve të bëra, po ashtu nuk ka mundur të vërtetoj datën e saktë të postimit, provat e bashkangjitura nuk argumentojnë datën e postimeve siç pretendohet në ankesa.

Bazuar në të lartcekurat Paneli pretendimet ankimore i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në prova konkrete, pasi që nga provat e bashkangjitura ankesave nuk mund të vërtetohet se mbështetësit dhe kandidatët e subjektit politik AAK-ALEANCA PËR ARDHËRINË E KOSOVËS, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, në rastet e lartcekura, të jenë gjetur në shkelje të nenit 37 paragrafi 1.2 i LZP, i cili përcakton *Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit* dhe atë: "1.Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre".

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", dhe bazuar në të gjitha të lartcekurat, paneli vlerësoj se pretendimet në ankesat e cekura më lartë janë të pa mbështetshme në prova dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara.

Nga sa u tha më lartë ankesat vlerësohen si të pa bazuara duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Anr.538/2025 datë 13.02.2025



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.